

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Trashëgimia kulturore e Durrësit në kërkim të publikut të saj të ri
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/09/06/trashegimia-kulturore-e-durresit-ne-kerkim-te-publikut-te-saj-te-ri/
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 23:00:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 07:24:37 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d68c2f30124e68dcb3a87a69a60b714c08072d74b6f12c461e76dcde5674b971
TEKSTI	17d7f80599040a8870b6a5e7d00e8cb7be1daae4677623a4491f68048dcc98aa
PAMJA	a33d0fb3a87ed1bc8e2ff2488542ea303f031f71f9f79c53c10e60c3783e0f86

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1aa0814a55ee12625f1df5e9531a3975c02cc7d741cb3a4615f98c0c733e8014
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	00a00f473eee6089e629c3f5b781cecb40006581d22ebdfab6238166e5deac
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	QmPnNf1qdmUZ7ZGmyYMWfEMaR1a5zbCFQKNxYmATJxZLPp



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1aa0814a55ee12625f1df5e9531a3975c02cc7d741cb3a4615f98c0c733e8014>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kryefaqja Reportazhe

Trashëgimia kulturore e Durrësit në kërkim të publikut të saj të ri

Edhe pse nxënësit përbëjnë një pjesë të vogël të vizitorëve të monumenteve të kulturës, disa iniciativa sporadike në Durrës po përpichen të ngjallin interesin e tyre për trashëgiminë e zonës.



nga Gëzim Kabashi — 11 hours më parë në Artikull kryesor, Reportazhe

Koha e leximit: 3 min lexim

AA

0



Një grup nxënësish vizitojnë amfiteatrin e Durrësit. Foto: Gëzim Kabashi.

Zade Allushi është nxënëse e shkollës së mesme të Ishmit dhe shpeshherë bashkohet me guidat lokale për t'u shpjeguar vizitorëve monumentet e zonës. Bashkë me Zaden ka edhe të rinj të tjerë nga Ishmi që ofrohen vullnetarisht, kryesisht duke përkthyer në gjuhën angleze.

Mësuesi Pëllumb Beja thotë se nxënësit e tij janë më shumë të interesuar të ushtrtojnë anglishten, se sa të njihen edhe vetë me trashëgiminë kulturore të fshatrave të Ishmit, e cila përbëhet nga bazilika e Gjericajt, kalaja e Skënderbeut dhe kisha e Shna Ndout në Kepin e Rodonit, apo kalaja e Ishmit në qendër të zonës.

"Falë anglishtes, pothuajse të gjithë janë punësuar në resortet e bregdetit të Lalzit," tha Beja me një dozë pesimizmi për interesin e humbur të të rinjve për trashëgiminë kulturore.

Njësia administrative e Ishmit shtrihet në pjesën veriore të bashkisë së Durrësit dhe ruan vetëm një pjesë të vogël të trashëgimisë kulturore në monumente qindrvjeçare. Numri i madh i objekteve të zbuluara dhe të pazbuluara ende i përket qytetit të Durrësit, por edhe këtu shqetësimi mbetet i njëjti: numri i ulët i vizitorëve në moshë të re.

Në muzeun arkeologjik kombëtar të Durrësit, vizitat në ekspozatë që prej disa javësh kryhen kundrejt biletave.

Turistët e huaj vijnë familjarisht dhe thuajse gjithmonë i kanë fëmijët me vete, ndërkohë që vendasit janë më të paktë në numër. Në periudhën janar-gusht, amfiteatri dhe kulla veneciane janë vizituar me pagesë prej afro 40 mijë vetëve, sipas statistikave të Qendrës Muzeore të Durrësit.

Por vetëm 4.962 prej tyre ose 12 për qind e totalit janë nxënës dhe studentë.

"Fëmijët e 9-vjeçares mbeten më të interesuar për monumentet dhe muzetë," tha për BIRN Antagoni Gjergji Suli, eksperte e trashëgimisë kulturore. "Ata janë të magjepsur nga e kaluara dhe kërkojnë të dijnë më shumë dhe të bëhen pjesë e programeve," tha ajo, duke theksuar nevojën për struktura të veçanta që i afrojnë të rinjtë me trashëgiminë kulturore.

Elvana Metalla me profesion arkeologe po përgatitet për ekspeditën e radhës, pranë amfiteatrit antik

Trashëgimia kulturore e Durrësit në kërkim të publikut të saj të ri

09:24 | 06/09/2026

Mbyllja e faqeve të mediave në platformat e Meta-s alarmon gazetarët shqiptarë

21:41 | 05/09/2026

Edhe një herë për çmimin e bananeve

09:31 | 05/09/2026

Vuçiçi i cilëson "budallallëqe" kritikant e BE-së ndaj nderimeve për Mlladiçin

17:50 | 04/09/2026

Kosova padit zyrtarë serbë të sigurisë për masakrën në kompleksin e familjes Jashari

17:26 | 04/09/2026

Gjykata i shpall të paligjshme arrestimet e 14 protestuesve të Kryeministria

17:24 | 04/09/2026

Ajo që e dallon misionin italo-shqiptar 22-vjeçar me studiues dhe studentë është interesimi i veçantë i kalimtarëve të shumtë, një pjesë e të cilëve janë nxënës të moshave të ndryshme.

Metalla tha për BIRN se bashkë me prindërit, fëmijët dhe të rinjtë e shumë që ndalojnë pranë kangjellave kërkojnë të dinë më shumë për zbulimet e antikitetit të vonë, mesjetës së hershme dhe të vonë, që lidhen ngushtësisht me etapat e zhvillimit të amfiteatrit.

Furra e qeramikës, poçet me qindra monedha, skeletet e familjarëve që mbetën në rrrënoja pas tërmetit të vitit 1273 apo banesat e shumta që mbijetuan në shekuj përbëjnë interes të veçantë.

Punonjësit e ekspozitës "Turistë të përgjuar" kanë qenë më konkretë. Fëmijëve që vijnë në mënyrë të organizuar u tregohen objektet e ekspozateve sikur të jenë lodra.

"Nuk zgjatemi më shumë se 30 minuta, por interesi është i madh," thotë Arjana Isaku, një nga krijueset e Ekspozitës.

Isaku pohon se bashkë me fëmijët janë xhiruar filma të shkurtër në mjediset e muzeut. Ata janë bërë të njohur për publikun dhe kanë gjetur miratimin e prindërve dhe mësuesve të tjerë – një bashkëpunim që pritet të vazhdojë edhe me fillimin e vitit të ri shkollor.

Disa fëmijë vizitojnë ekspozitën "Turistë të përgjuar". Foto: Gëzim Kabashi.

Etiketa: Antigoni Gjergji Suli Arjana Isaku Bashkia Durrës Elvana Metalla
Njesia administrative Ishem Pellumb Beja Trashëgimia kulturore